



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Municipal Istog
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.51/23

Datë: 20.01.2023

Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog duke u bazuar në nenin 67 dhe 68 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publik, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 35 të Ligjit Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës, UA-MPMS, Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik ,UA-MASHT, Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe UA-MASHT, Nr.01/2022 për Ndryshim dhe Plotësim të UA-MASHT, Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, shpall këtë:

KONKURS

SHFMU "Bajram Curri" në Istog

1. Një Mësimdhënës/e për gjuhë shqipe vendi i lirë i punës nga data 08.05.2023 normë jo e plotë
2. Një mësimdhënës/e për gjuhë shqipe me plotësim norme në SHFMU "Martin Camaj" Gurrakoc gjithsejtë 10 orë.
3. Një mësimdhënës/e për mësim klasor (1-5) zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë nga data 01.05.2023

SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë

1. Një Mësimdhënës/e për gjuhë shqipe vendi i lirë i punës nga data 15.04.2023
2. Një punëtor teknik (pastrues/e) vendi i lirë i punës nga data 22.03.2023 në shkollën amë.

SHFMU "Avni Rrustemi" në Zallq

1. Një Mësimdhënës/e për gjuhë shqipe vendi i lirë i punës nga data 25.04.2023
2. Një punëtor teknik (pastrues/e) zëvendësim, derisa punëtori të kthehet nga pushimi mjekësore.

SHFMU "Ismail Qemali" në Saradran

1. Një punëtor teknik (pastrues/e) vendi i lirë i punës nga data 15.05.2023

SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh

1. Një punëtor teknik (Shtëpiak) në tri shkolla SHFMU "Tre Dëshmoret" Uçë dhe SHFMU "Mehmet Akifi" Shushicë vendi i lirë i punës nga data 06.04.2023
2. Një punëtor teknik (pastrues/e) vendi i lirë i punës nga data 10.05.2023

Gjinnazi "Haxhi Zeka" në Istog

1. Një Mësimdhënës/e për edukatë muzikore vendi i lirë i punës norme jo e plotë.

IP "Gëzimi Ynë" në Istog

1. Një edukatore për grup moshat (3-6) zëvendësim derisa punëtorja të kthehet nga pushimi mjekësore-Rakosh
2. Një punëtor teknik (pastrues/e) vendi i lirë i punës në Rakosh.

IP "Ardhmëria Jonë" në Gurrakoc

- 1.Një punëtor teknik (pastrues/e) vendi i lirë i punës nga data 14.06.2023

Për vendin e punës punëtor/e ndihmës/e është obligative që kandidatët ta kenë të përfunduar shkollën e Mesme të Lartë.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Certifikata e lindjes.
- ~~Kopja e diplomës ose certifikata në vend të diplomës jo më e vjetër se gjashtë muaj, çdo certifikatë me e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh~~
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Certifikatën nga Gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetim , jo më e vjetër se 6 muaj.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ, MASHTI, Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA-MASHT, Nr.05/2015 për Normativin për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 20.02.2023 deri më datë 06.03.2023.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100, kati përdhës dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës, po në të njëjtën zyrë.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje. Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit, ndërsa i njëjti nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili dorëzohet pas afatit nuk do të shqyrtohet . Gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit (kërkesën) do të refuzohet.

Në testin me shkrim do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret, bazuar në aktet normative dhe legjislacionin në fuqi. Kurse intervistës do t'i nënshtrohen vetëm kandidatët – kandidatet, të cilët- të cilët do të kenë me shumë se 50 për qind të kalueshmërisë se testit më shkrim.



Dirigjenti i DKA-së
Naim Behlulaj